



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME PLENARE TË KUVENDIT TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 19 NËNTOR 2025, ora 14.00**

**SA VANREDNE PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 19. NOVEMBRA 2025. GODINE, 14.00 časova**

**NËNTOR - NOVEMBAR
2025**

Rendi i ditës

1. Zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Dnevni red

1. Izbor Vlade Republike Kosova.

Seancën e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Dimal Basha.

KRYETARI: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të dashur qytetarë,
I nderuar Kor diplomatik, i akredituar në Republikën e Kosovës,
I nderuar kryetar i Komunës së Shtimes, zoti Qemajl Aliu,
Të nderuar mysafirë të pranishëm në këtë seancë,
Të nderuar përfaqësues të mediave,
Po fillojmë punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas kërkesës së 41 deputetëve të Kuvendit, me një pikë të vetme të rendit të ditës:

1. Zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës

Të nderuar deputetë,
Në mbështetje të nenit 95 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Presidentja e Republikës së Kosovës, zonja Vjosa Osmani-Sadriu, me dekretin nr.184/25 të datës 4 nëntor 2025, ia ka propozuar Kuvendit të Republikës së Kosovës zotin Glauk Konjufca kandidat për kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës. Në këtë rast ftoj kandidatin për kryeministër, zotin Glauk Konjufca, për të paraqitur përbërjen e Kabinetit qeveritar, si dhe ekspozenë e tij për mandatin e ardhshëm qeverisës.

Zoti Konjufca, fjala për ju!

GLAUK KONJUFCA: I nderuar kryetar i Kuvendit, Dimal Basha!
Të nderuar deputetë,
Të dashur ambasadorë të vendeve mike në Republikën e Kosovës,
Të dashur mysafirë,
Të nderuar gazetarë të pranishëm,
Për herë të parë në jetën e vet parlamentare Kuvendi i Republikës nuk arriti ta legjitimojë me votë qeverinë e shtetit.

Votimit të 26 tetorit i parapriu një krizë gjashtëmujore, e cila ishte rezultat i pamundësisë për ta zgjedhur kryetarin e Kuvendit. Viti 2025 do të mbahet mend si një vit, shumica e të cilit humbi në përpjekje për themelimin e institucioneve tona kushtetuese, Kuvendit dhe Qeverisë. Përkundër kësaj, viteve të fundit arritjet e Kosovës, të shtetit tonë, nuk janë të vogla. Po hyjmë në vitin e pestë në rritje ekonomike mbi 4% dhe disiplina fiskale po shkon duke u konsoliduar.

Borxhi i jashtëm ndodhet në pikën e tij historikisht më të ulët, kurse mbledhja e brendshme e tatimeve, bashkë me qarkullimin e bizneseve, ka shënuar rritje enorme. Në Veri të vendit janë luftuar me sukses strukturat e Serbisë të lidhura me krimin e organizuar, si dhe me kontrabandën,

kurse buxheti për mbrojtje është katërfishuar, e po ashtu është rritur nëpër sektorë vitalë të shtetit tonë. Në planin ndërkombëtar gjatë këtij mandati u mundësua lëvizja pa viza në zonën Shengen të qytetarëve tanë, kurse erdhën po ashtu edhe tri njohje ndërkombëtare shumë të rëndësishme për Republikën e Kosovës. Këto janë bërë falë punës së mirë të Qeverisë Kurti.

Të nderuar kolegë,

Tash jemi në fazën e mandatarit të dytë për krijimin e qeverisë. Me këtë animozitet të spektrit tonë politik, vështirë që do të arrijmë edhe një konsensus për zgjedhjen e presidentit në muajin mars. Pa një qeveri të re, vendi ynë e ka të sigurt vetëm një gjë: thellimin e krizës aktuale! Përmes themelimit të kësaj qeverie sot ne synojmë disa gjëra bazike për shtetin tonë.

Së pari, synojmë ta kursejmë Kosovën nga dy palë zgjedhje eventuale. Do të ishte arrogancë ta çonim vendin tonë drejt e në zgjedhje, patëm zgjedhje në shkurt të këtij viti, e pastaj dy raunde zgjedhjesh lokale në tetor dhe nëntor.

Tash, nëse shkojmë në zgjedhje të reja në dhjetor, kush na garanton që do t'i shmangim ato edhe në mars. Nuk ka kurrfarë garancie, e nëse kjo ndodh, institucionet duhet të jenë gjithnjë të përgatitura, ama për qytetarët tanë është rraskapitëse, për KQZ-në një sfidë, të cilën kurrë nuk e kanë provuar, është e paprecedentë, kurse për taksat e popullit edhe 8 milionë euro të tjera të harxhuara pa arsye.

Të mos harrojmë po ashtu që ideja e domosdoshmërisë të një qeverie përmes mandatarit të dytë lindi pas dështimit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit. Në mbledhjen e parë të Kryesisë së Kuvendit Lëvizja Vetëvendosje propozoi që përmes një marrëveshje politike të themelohen trupat e Kuvendit, në këtë rast komisionet parlamentare, ashtu që ato së paku të mund ta trajtonin buxhetin e ri të vitit 2026.

Grupet parlamentare nuk u pajtuan, prandaj e vetmja rrugë është ezaurimi i mundësisë për krijimin e qeverisë në tentimin e dytë që i hap rrugë funksionalizimit të Kuvendit. Tre hapa esencialë janë ndërmarrë nga Vetëvendosja për shmangien e zgjedhjeve të njëpasnjëshme.

Së pari, dy letra për koalicion drejtuar partisë së tretë, të cilat u refuzuan. Së dyti, përpjekja që në Kryesi të Kuvendit të gjendet një marrëveshje për themelimin e komisioneve parlamentare, së paku për trajtimin e buxhetit, edhe kjo dështoi. Dhe, e treta është kjo e fundit, ku ndodhemi tash, është votimi i Qeverisë së mandatarit të dytë.

Nëse dështon edhe kjo e treta, atëherë pashmangshëm shkohet në zgjedhje të reja parlamentare, ama duhet ta dimë secili se çka mund të bartë mbi supe, e këto janë përgjegjësi të ndryshme. Disa çështje, të cilat qeveria jonë do t'i trajtojë me urgjencë, janë: buxheti i shtetit për vitin 2026, miratimi i planit të rritjes së Bashkimit Evropian, disa marrëveshje të rëndësishme financiare

ndërkombëtare, përfshirë edhe ato me Bankën Botërore, ekzekutimi i pagave të punëtorëve të Radiotelevizionit të Kosovës, si dhe miratimi i buxhetit për komunat: Prishtinë, Gjilan dhe Zubin Potok.

Dua t'jua risjell në mendje po ashtu që unë po kërkoj nga ju diçka që ne vetë e kemi pas bërë në vitin 2020. Të gjithëve na kujtohet se si Vetëvendosja e pati votuar buxhetin e Qeverisë Hoti, më 29 dhjetor 2020. Neve nuk na u pat dukur ai buxhet i personit Avdullah Hoti, por i shtetit të Kosovës. Edhe ne mund të mos e kishim votuar atë buxhet, ama do të bëheshim përgjegjës për një krizë, nga e cila rrezikoheshin drejtpërdrejt të gjitha pagat e sektorit publik.

Ne atëherë e bëmë dallimin mes asaj që ishte interes publik dhe betejë politike e përditshme. Ne atëherë e ditëm që po të mos votohej ai buxhet nga ne, kryeministrit në atë kohë Hoti ndoshta do t'ia kishim bërë një goditje simbolike, ama goditjen më të madhe do ta kishin marrë ushtarët e policët tanë, arsimtarët e mjekët tanë, administrata e pensionistët tanë. Ne e kapërcyem veten atë ditë, e njëjta po kërkohet edhe nga ju sot.

Sot jam këtu para jush për ta vendosur politikën në rrafshin e saj më të lartë, përgjegjësinë para qytetarëve. Shteti nuk është në skenë ku luajnë vetëm interesat, shteti para se gjithash është një marrëveshje etike për të mirën e përbashkët. Në këtë kuptim nuk ka vlerë menaxhimi i status quo-s, por e rëndësishme mbi të gjitha është tejkalimi i saj. Ne mund ta hapim një horizont të ri, të dashur kolegë, një horizont ku askush nuk humb asgjë, por përkundrazi rirreshtohen mundësitë për të gjithë pa përjashtim.

Institucionet nuk ekzistojnë për ta mbrojtur forcën bllokuese a penguese, por për t'i fuqizuar qytetarët dhe popullin. E ardhmja nuk ndërtohet me frikë e drojë, por me vetëbesim dhe me dije. Prandaj, çdo vendim, çdo politikë, çdo hap duhet të matet me pyetjen: a e çliron kjo apo e kufizon potencialin zhvillues e ndërtues për qytetarët? Sot ia vlen të zgjedhim rrugën në dukje të komplikuar ndoshta, por ne nuk kemi nga askush tjetër këtu jashtë nesh, jashtë këtij Parlamenti që i grumbullon të zgjedhurit e popullit, që ta presim drejtësinë e veprimeve tona. Atë duhet ta krijojmë vetë ne, të udhëheqim me guxim edhe në shtigje të pashkelura më herët.

Burimi i këtij guximi duhet të na karakterizojë të gjithëve sot, e ky është besimi te qytetarët tanë, si dhe obligimi që e kemi ndaj sakrificave e kontributit të paraardhësve, e jo më pak edhe ndaj ëndrrave e dëshirave të pasardhësve tanë. Qytetarët na duan neve që t'i zbatojmë detyrat që i kemi marrë. Si përfaqësues të tyre, ne duhet ta kryejmë detyrën tonë, ta pajisim vendin me një Qeveri.

Rritja ekonomike edhe sivjet do të jetë, e kam fjalën për vitin e ardhshëm, sepse po hyjmë tashmë gati në vitin 2026, mbi 4 për qind të bruto prodhimit vendor. Rritja e konsumit të eksporteve dhe investimeve kapitale është e qëndrueshme. Kjo na mundëson që ta rrisim, ta

shpërndajmë rritjen e zhvillimit ekonomik e që zhvillimin ta kthejmë pastaj në progres, që ekonominë ashtu ta kemi në shërbim të shoqërisë sonë.

Viti i ardhshëm do të jetë, në njërin anë, vit i investimeve kapitale me mbi një miliard euro, i mbështetjes së prodhimit në sektorin privat me financim deri në 1 miliard euro. Edhe kjo i fillimit urgjent të hekurudhës Prishtinë-Durrës dhe i pesë digave për akumulimin e ujit e i projekteve të reja energjetike me burimet që i kemi.

Kurse, në anën tjetër, po ashtu vit i rritjes së pagës minimale në 500 euro, i mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve, i reformës së sistemit tonë pensional, i fillimit të ndërtimit të sistemit informativ shëndetësor për fondet e sigurimeve shëndetësore. Me llogaridhënie të rregullt e transparente të proceseve, me sundim të ligjit e të rendit publik, do të jemi në nivel të përgjegjësisë shtetërore me funksionet që bartim dhe detyrat që i kemi para nesh.

2026 do të jetë viti i fillimit të transformimit të shëndetësisë publike në të gjitha regjionet e Kosovës, prej spitaleve të reja që do të fillojnë të ndërtohen, te poliklinikat specialistike nëpër të gjitha anët e Kosovës. Është viti i fillimit të punës për ngrohtoret qendrore në regjionet që po presin prej vitesh, e po ashtu edhe viti i fillimit të mbështetjes për vajzat dhe gratë si asnjëherë deri më tani, pra edhe i mbështetjes me programe speciale për punësimin e tyre.

Të rinjve në sektorin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit do t'u qasemi me investime që do ta ngrejë këtë sektor në një nivel të ri. Kështu do ta mundësojmë kapërcimin e madh nga ndërmarrësia individuale në investimet strategjike madhore dhe krijimin e ekosistemeve të reja vendore. Do të realizohen edhe qindra projekte të tjera të rëndësishme infrastrukturore si dhe në çdo fushë të shtetit tonë.

Të dashur kolegë,
Zonja dhe zotërinj,
Më lejoni që ta prezantoj Kabinetin e Qeverisë së re:

Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Albin Kurti.
Zëvendëskryeministre e dytë dhe ministre e Drejtësisë, Donika Gërvalla,
Zëvendëskryeministër i tretë për Çështje të Pakicave dhe Bashkëpunim, Fikrim Damka,
Ministër i Financave dhe Ekonomisë, Hekuran Murati,
Ministër për Familje dhe Mirëqenie Sociale, Andin Hoti,
Ministër i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci,
Ministër i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla,
Ministër i Administratës Publike dhe Digjitalizimit, Lulzon Jagxhiu,
Ministër i Shëndetësisë, Arben Vitia,
Ministër i Arsimit dhe Shkencës, Avni Zogiani,

Ministër i Kulturës dhe Turizmit, Fatmir Spahiu,
Ministër i Sportit dhe Rinisë, Blerim Gashani,
Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal, Rasim Demiri,
Ministre e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fitore Pacolli
Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Armend Muja,
Ministër i Infrastrukturës dhe Transportit, Besnik Bislimi,
Ministre e Tregtisë, Industrisë dhe Integriteteve Evropiane, Mimoza Kusari-Lila,
Ministre e Energjisë dhe Minierave, Artane Rizvanolli,
Ministër për Komunitete dhe Kthim, Nenad Rashiq,
Ministër për Zhvillim Rajonal, Sejmur Vejshall.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, z. Konjufca!

Tani është koha për diskutime.

Fillojmë me përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Fillojmë me grupin më të madh. Kush flet në emër të Lëvizjes Vetëvendosje? S'kemi.

Atëherë vazhdojmë me Partinë Demokratike të Kosovës. Fjalën e ka Uran Ismaili.

URAN ISMAILI: Të nderuar deputetë!

Të dashur qytetarë.

Sot jemi thirrur në një seancë, e cila në thelb është e pakuptimtë, sepse rezultatet i dimë pothuajse të gjithë. Fillimisht, është e pakuptimtë sepse nuk ka njeri as në Lëvizje Vetëvendosje e askund në Kosovë, e fatkeqësisht as vetë kandidati, z. Konjufca, që beson se mund të jetë kryeministër i vërtetë e z. Kurti zëvendës i tij.

Kjo seancë është farsë, është i njëjti mentalitet që bllokohej Kuvendi me emrin e Albulena Haxhiut, gjersa Kosovës i shtoheshin problemet, thelloheshin problemet e familjeve në Kosovë, thellohej kriza e rritjes së çmimeve dhe rëndohej gjendja ekonomike në Kosovë, rritej çmimi i energjisë elektrike, mungesë të madhe të barnave si dhe të rinjtë e familjet e Kosovës e lëshonin Kosovën.

Në tërë këtë kohë bllokohej Kuvendi me emrin e Albulena Haxhiut. Dhe, në fund, kur erdhi zgjidhja me emrin e Dimal Bashës, edhe vetë deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje çuditeshin çka ndodhi dhe pse humbëm kaq shumë kohë e pse kaq shumë kohë humbi Kosova.

Kosova ka hyrë në një mentalitet bllokues dhe arkitekt i këtij mentaliteti bllokues është vetë z. Kurti. Është dëshpëruese ta shohim Kuvendin e Kosovës me këtë mentalitet bllokues që dhjetë muaj. Natyrisht, ne kemi tentuar ta tejkalojmë këtë situatë, kemi pranuar ftesë nga z. Kurti dhe z. Krasniqi si kryetar i PDK-së në atë kohë ka ardhur në takim për të luajtur rolin e tij si udhëheqës i grupit tonë parlamentar. Edhe kur kemi qenë konstruktiv, prapëseprapë kriza institucionale ka

vazhduar, sepse z. Kurti fare s'i ka interesuar çka janë problemet ditore të familjeve në Kosovë. Krejt çka i intereson z. Kurti është qysh t'ia lërë fajin ish-opozitës.

Prandaj, kjo seancë është farsë. Me një kandidat që e di vetë që nuk mund të luajë rolin e kryeministrit, edhe po t'i ketë votat për Qeveri. Qysh mund të jetë dikush kandidat për kryeministër që ia vendos dikush tjetër emrat e ministrave e ai s'ka të drejtë të propozojë gati asnjë emër për ministër. Ky është tregues i mjaftueshëm se çfarë kandidati për kryeministër është. Çka na tregon kjo është që z. Konjufca është marrë peng, që në krye të Qeverisë propozohet dikush që krejt Kosova e di që nuk është kryeministër në realitet. Kërkohet vota e deputetëve për të legjitimuar marrjen peng të z. Konjufca.

Zoti Konjufca nuk është kandidat që e ka të drejtën të propozojë e as të kritikojë askënd. A mund të distancohet z. Konjufca dhe të kërkojë hetim të zgjeruar ndaj tenderëve njëburimorë në KEK e abuzimeve milionëshe? A mund të distancohet z. Konjufca dhe të kërkojë hetime të zgjeruara ndaj Martin Berishës dhe aferës së përfolur, ku ambasadori Berishaj ka tërhequr miliona euro në bankat e Kosovës nga pagesat direkte nga Serbia për rolin e tij të ndërmjetësimit të shitjes së energjisë elektrike? A mund të distancohet z. Konjufca dhe të kërkojë hetime të zgjeruara për ministren Hajdari dhe abuzimet me rezervat e shtetit? A mund të kërkojë z. Konjufca përgjegjësi e hetime, që për herë të parë në Kosovë shërbimet jetike shëndetësore janë duke u përgjysmuar dhe duke e rrezikuar jetën e qytetarëve, siç është rasti me shërbimet e hemodializës që po ndodh tani?

Z. Konjufca as nuk mund të propozojë ministra për të ardhmen e as nuk mund të distancohet nga abuzimet e së kaluarës. Prandaj, vota e PDK-së do të jetë kundër, por po ashtu jemi krejt të vetëdijshëm se kjo seancë nuk është për t'u zgjedhur kryeministri, po për të tentuar të fajësohet ish-opozita.

Të dashur qytetarë,

Sot Lëvizja Vetëvendosje po vazhdon të tentojë ta zgjasë krizën. Qëllimi i PDK-së është të dilet nga ky ngërç dhe nga kjo krizë që po u shkakton humbje të madhe qytetarëve të Kosovës dhe vetë Kosovës. Këta po kërkojnë: hajde e zgjatim krizën deri në prill, vazhdon kriza për popull, po me rëndësi vazhdojnë privilegjet për neve si Qeveri.

S'ka më privilegje qeveritare për askënd derisa ka krizë në Kosovë. Mos u fshihni më pas emrave të askujt. Zgjedhjet na qesin përballë popullit dhe çdo politikan i mirëfilltë nuk i ikën ballafaqimit me popull.

Mos i ikni ballafaqimit me taktizime të emrave e zgjatje të krizës! Faleminderit!

KRYETARI: Tani nga Lidhja Demokratike e Kosovës fjalën e ka deputeti Lumir Abdixhiku.

LUMIR ABDIXHIKU: Të dashur qytetarë!

Kolegë deputetë,

Sot dua t'i drejtohem kësaj salle me një pamje shumë të thjeshtë, por ironikisht e fatkeqësisht shumë domethënëse për realitetin politik tonin, atë të Don Kishotit; jo si figurë e letërsisë, por si një metaforë politike, sepse, për fat të keq, shteti ynë, shoqëria jonë, Republika jonë ka një kohë që po udhëhiqet jo nga arsyeja, por nga një realitet paralel që e sheh vetëm një njeri politik në vend, Albin Kurti.

Për ju të pushtetit që bërtisni teksa flasim ne këtu, që leximin nuk e keni pasur as dëshirë, as qëllim e duket as obligim, Don Kishoti është një nga personazhet më të famshme të letërsisë botërore, një figurë komplekse, idealiste, tragjike, shpeshherë dhe thellësisht komike. Pra, një figurë tragjikomike.

Sikurse Don Kishoti i Servantesit, edhe Albin Kurti i Vetëvendosjes zgjohet çdo ditë, çdo mëngjes në një botë që e ka krijuar vetë; dhe në atë botë, Albin Kurti i Vetëvendosjes sheh dhe krijon veç kundërshtarë. Kundërshtarë që duan ta kthejnë Serbinë në Kosovë na thotë të gjithëve. Edhe ty gjeneral Hadërgjonaj, edhe ty Ramush, edhe ty Fatmir, edhe juve burra e gra që keni luftuar për lirinë e Kosovës.

Pra, të gjithë ju, të gjithë ne në këtë sallë duhet ta kthejmë në realitetin e Albin Kurtit Serbinë në Kosovë. Kundërshtarë që duan ta bllokojnë Kosovën, vendin tonë, vendin ku për dallim prej teje, ne i rrisim fëmijët tanë këtu, Albin, pasurinë më të madhe që e kemi.

Pra, ne duhet ta bllokojmë edhe këtë vend të fëmijëve tanë. Kundërshtarë të tjerë që punojnë ditë e natë pa ndërprerë që ky të mos ketë sukses. Po pra, këta kundërshtarë janë edhe në Parlament, edhe në parti, edhe në gjykatë, edhe në prokurori, edhe në media, edhe në shoqërinë civile, janë besa brenda vendit e jashtë vendit, edhe tek aleatët tanë.

Në vend se të merret e të përballlet me realitetin e vendit, në vend se të merret e të përballlet me ekonominë që është rrënuar e është duke ngecur si asnjëherë më parë, me barrën e madhe të familjeve tona, të punëtorëve tanë; në vend se të merret me izolimin që na i ka mbyllur dyert me një botë të tërë, e po e kthen Kosovën në një vend të zymtë, në vend se të merret me skandalet e mëdha korruptive, që i sillen rreth rrethit të tij.

Thatë, familjarëve, por që në thelb gërryejnë besimin e qytetarëve në gjithçka që sot duket si shtet. Ai ka zgjedhur të ndërtojë përballje të shpikura me mullinj të erës me asnjë problem real të Kosovës, sepse temat që i prekin qytetarët tanë nuk janë as qëllim, as prioritet i tij. Po të ishin, do të ishin zgjidhur, ose të paktën do të ishin provuar të zgjidheshin.

Fundja, ai që e ka brengë bllokadën, ai që e ka brengë krizën, nuk i shpenzon 15 ditë kot, 15 ditë të vlefshme para krizës për të ardhur në rezultatin e njëjtë pa vota për shumicë. Por, ai që do kundërshtarë, që do shfaqje teatrale, që do skenë, që do mullinj të erës sikur Don Kishonti, ashtu Albin Kurti pret tension, pret përplasje, pret konflikt.

Në ekzistencën e tij politike, Albin Kurti nuk di e nuk do të jetojë pa kontrast politik. E krijon këtë kontrast. E ushqen këtë kontrast. Punon dhe jeton për këtë kontrast, sepse pa të s'bën asgjë, s'ecën asgjë, s'është asgjë. Dhe, sot e shohim këtë ditë kështu. Merreni si të tillë. Një shfaqje teatrale, jo për qëllim të zgjidhjeve të problemeve, por për material elektoral të një fajësimi që na prodhon kontrast.

Një njeri me apetit të pakufizuar për karrige. E çuditshme. Një njeri që është në gjendje ta bllokojë gjithë Republikën e Kosovës për 10 muaj rresht. Të rrënojë secilën vlerë demokratike, qytetare, kushtetuese e morale të këtij vendi. Një njeri që është në gjendje ta shfryjë gjithë helmin, gjithë pezmin që e ka kundër kolegëve të vet, të partive të tjera, të qytetarëve të vet për një karrige. Sa e padinjitetshme.

Të shoh të rrethuar sikur Don Kishoti me Sanço Pançon që duartrokas, t'u justifikojnë çdo dështim. Që t'u ushqejnë çdo fantazi që e ke vetëm për të ruajtur privilegjin e vogël të tyre për të ecur pas pluhurit tënd. Dhe, këta Sanço Panço janë në gjendje të na i shpenzojnë edhe 15 ditë. Ka të tillë që na i marrin 15 ditë dhe na vijnë e na mbajnë fjalime këtu se duhet të votojmë për të mirën e Republikës. Dhe, ata jetojnë në një vend paralel, në një botë paralele, kur nuk e ke të qartë më se a janë brengat e njëjta, faktet e njëjta, qëllimet e njëjta.

Ja ku jemi sot me një vit të humbur. Me 15 ditë tjera me vetëdije se rezultati do të jetë i njëjtë. Pa asnjë komunikimin ndërpartiak. Me imponim të plotë, me vetëdije të plotë për të prodhuar kontrast. Dhe, me një shfaqje teatrale si sot kjo këtu, me një çmenduri të vitit 2025, që duhet ta mbyllim. Kosova nuk duhet, dhe ju them se s'duhet të mbahet peng i udhëtimit imagjinar. Nuk mund të qeveriset as me fantazi të një njeriu, e me përplasje të shpikura tradhtarësh, patriotësh, bllokuesish e punuesish, teksa njerëzit tanë janë në hall dhe vendi ynë është në paqartësi.

Republika e Kosovës nuk duhet të lihet në duar të atyre që luftojnë me mullinj ere dhe ndjekësish që u shkojnë pas.

Prandaj, sot, në emër të LDK-së, le ta mbyllim këtë seancë me një të vërtetë të thjeshtë dhe një thirrje të madhe, koha e donkishotëve e sançopançove duhet të mbarojë në Kosovë. Duhet të përfundojë, sepse Kosova nuk është novelë e një njeriu me fantazi, Kosova është Republikë, Kosova është përgjegjësi, Kosova është detyrim. Jemi shumë më shumë sesa që janë këta. Le të bëhemi gati për zgjedhje. Le t'i japim fundin e merituar një propagande populliste. Le t'i japim dritë Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETAR: Tani nga grupi parlamentar Lista serbe. Deputeti Igor Simiq e ka fjalën.

IGOR SIMIĆ: Poštovani predsedavajući,

Poslanici,

Građani,

Prošlog puta ste izneli jasan stav, i pošto vidimo da je ovo ista priča, samo drugo pakovanje, stav je isti. Doneli ste stotine odluka pod svešču protiv srpskog naroda. Niste doneli ništa dobro ni albanskom, bošnjačkom, goranskom, egipćanskom, romskom, i bilo kom drugom narodu. Ono po čemu ste ostali upamćeni, bićete upamćeni po kršenju svih mogućih propisa, po stvaranju diktature, i po strašnoj želji da po svaku cenu sačuvate fotelje, privilegije, i da pobegnate od glasa naroda.

Zato Srpska lista neće podržati ovo, i zato idemo na izbore, i tu ćete videti kakav će odgovor građani dati na sve ono što ste radili. Još jednom, Srpska lista ne glasa za ono što je Albin Kurti spremio, a uvio u oblande.

KRYETARI: Faleminderit!

Nga Grupi Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ramush Haradinaj.

RAMUSH HARADINAJ: Të nderuar deputetë,

Media,

Kor diplomatik,

Të dashur qytetarë, bashkëkombës shqiptarë, kudo që ndodheni,

Jo për shkak të formës, por për shkak të respektit, të peshës së proceseve, kritikën e parë për mandatarin e sotëm e kam se nuk na e dha një listë me emrat e Kabinetit qeveritar. Pra, jo vetëm për shkak të formës. Jemi Parlamenti i Kosovës. Po propozohet, qoftë edhe si formë një Qeveri. Ka qenë e udhës të na jepen këta emra. Pra, nuk është se dëmtohet, ose ndonjë sekret deri në votim. Do të ishte respekt.

Po ashtu, në këtë kritikë më duhet ta bashkoj, por jo vetëm për shkak të formës, mungesën e një programi qeverisës. Kandidati i sotëm, mandatarin i ri, në këtë rast zoti Konjufca, foli për disa qëllime. Përmendi vitin 2026. Nuk dëgjuam vite të tjera. Çka është 2027-ta, 2028-ta, 2029-ta. Thua se po aplikon për një qeveri 1-vjeçare.

Jo vetëm për shkak të formës, është e logjikshme t'i jepet një vizion, qoftë edhe nëse dështon nuk i merr votat, por një vizion se çfarë synon të mbërrijë.

Të nderuar deputetë,

Sot u sqarua edhe situata e rëndë me buxhetin. Dhe, na u tha se dikur e keni votuar buxhetin e një qeverie. Tani pyetja është për të gjithë ne: a kemi ne qeveri që t'ia votojmë dikujt buxhetin? Pra,

të mos e harroni, sikur ta kishim një qeveri, se ka raste në këtë Parlament, krejt opozita e sotme i ka votuar marrëveshjet ndërkombëtare me 2/3 dhe ka votuar edhe ligje disa herë, jo vetëm një herë. Ju e përmendët një rast që VV e ka bërë këtë, por unë e di personalisht që e kam ngritur dorën disa herë gjatë këtij mandati në interes të qytetarëve të Kosovës. Tani s'kemi qeveri.

Si do të mund ta evitonim ne dëmin që u shkaktohet qytetarëve të vendit, të gjithëve, dhe proceseve të këtij vendi? Besoni, duke fituar në kohë.

Një kritikë për mandatarin e sotëm është, po ashtu, nuk po flas për të gjithë. I nderuar mandatar, kur e keni marrë mandatin, a e keni shqyrtuar a i keni 61 nënshkrime, 61 deputetë, dhe kur e keni ditur që s'i keni? Ndoshta s'e dini as sot dhe e provoni në votë. Por, besoni që çdo ditë e fituar për Kosovën do të ishte një reflektim, një përgjegjësi.

Më duhet t'ju tregoj, jo vetëm ta ballafaqojmë mandatarin e sotëm edhe ata kolegë që u kandiduan për qeveri, por më duhet t'ju drejtohem me disa situata, t'jua shpjegoj disa situata.

Po ju pyes personalisht, mandatar, a ka ndryshim në investimet e mëdha kapitale? Për shembull, nëse do të shkosh në Gjilan, a ka autorrugë të ndërtuar që 5 vjet? Ka qenë e paguar gjysma e kësaj autorruge, ka qenë e kontraktuar, ka qenë në projekt.

Të mos harroni një gjë, çka është kjo autorrugë? Nuk është vetëm për Gjilanin. Kjo autorrugë është për ta bashkuar Luginën, të shkohet te Dheu i Bardhë ndonjë ditë. Prej aty ne të vazhdojmë me fuqinë tonë. Nuk është pak kjo pyetje imja.

E njëjta situatë, për fat të keq, vlen edhe për Mitrovicë. Që sa vjet është në projekt që të kryhet autorruga deri në Mitrovicë? Besoni, nëse je për ngut dhe do që të shkosh në Mitrovicë. Do ta kesh problem. Ose, nëse është një lehonë që duhet të vijë prej atje, këtu. Ose, nëse është një urgjencë në veri.

Pra, aq sa kanë qenë interesante urat e që janë të mira, e shqyr që ka ura e më shumë ura u bëfshin, e njëjta strategji do të duhej që të vlente, në mënyrë që të kryhet me shpejtësi autostrada deri në Mitrovicë, e ndoshta edhe më thellë, se është depërtim i fuqisë sonë.

Të mos flasim për autostradën për Pejë, ose autorrugën. Ju kuptojmë, keni pasur dyshimet tuaja se ka keqpërdorime. Se ato huat që i kemi marrë në BE, që të mos e shtimë buxhetin tonë menjëherë për ta mbajtur peng. Se po do dikush t'i keqpërdorë për ara. Në rregull! Më fal, cila është dinamika? A e dini që s'keni mbërri ende deri në Dollc. A e dini që me këtë shpejtësi, 5 vjet për të mbërri deri në Dollc, edhe nuk kemi mbërri deri në Dollc. Problem për besë. Besoni, një qytetari të Kosovës boll zor e kemi se si t'ia sqarojmë këtë punë.

E kemi pasur të kontraktuar e të projektuar, çdo gjë në rregull që të lidhet Gjakova me një autorrugë. Ndonjëri mund të thotë, pse Gjakovën? Nëse për kurrëgjë tjetër, kolegë, është një aeroport aty. Aeroport ushtarak, edhe civil. Ajo rrugë nuk është bërë pahiri, pra trajektorja për të shkuar, se kur të mbërrin në Kodër të Becit e lidh me aeroport.

Në anën tjetër të kësaj autorruge e kemi lënë një zonë biznesore, zonë industriale për investimet amerikane. Një hap, që do të thoshte ky i ekonomisë, edhe një ofertë për ta. E kemi ditur që vjen hekurudha, po ashtu, nëpër Gjakovë, kështoj ne e kemi paraparë një lloj, po e quaj ashtu, zone të sigurt, ka një poligon ushtarak më prapa atje. Ka qenë një zonë me rëndësi. Pse, ju lutem, 5 vjet është gjendja ashtu siç është? Tash, nëse doni mund ta vazhdoj. Nuk po hyj më thellë.

Ju na treguat neve që keni mbërri ta shpërndani buxhetin drejt. Shikoni! Është mirë t'u jepen studentëve nga 100. Besoni, është mirë. Unë gëzohem kur i merr studenti 100 euro. Por, a mos është më mirë t'ua bëjmë ndonjë bursë të përhershme. Urdhëro?! Edhe atë a? E atëherë, këto 100-shet a janë bursë apo shtesë? Aha, mirë shumë!

Ju lutem, ka plot studentë në Kosovë që s'kanë bursa, qysh e dini. Edhe unë i falënderoj edhe komunat që u japin bursa, edhe individë, edhe në sektorin privat kushdo që jep bursa, por do të ishte mirë t'ua bëjmë një bursë të përhershme të rinjve tanë që janë duke na u pakësuar. Sepse kur ua jep veç një herë në vit, nuk është që ua ke zgjidhur problemet. Është e mirë.

Kemi kërkuar pagën minimale që të rritet më herët. Kemi kërkuar që të rriten pensionet. Si ka mundësi që të rriten këto pensione veç tash kur s'po i merrni votat që ta bëni qeverinë. Pra, merreni me mend, i keni rritur pensionet pas dështimit të mandatarit të parë deri në mandatarin e dytë. Nejse, dikush mund të thotë, edhe kjo është e moralshme. Në rregull!

Vetëm, pse bre s'i keni bërë pak më herët. Nja dy-tre muaj, në mënyrë që ne ta dimë që diçka është në rregull në këtë vend, por e gjetët kohën kur njëri dështon të votohet, tjetri s'është votuar, edhe i votoni këto. Besoni, do ta kalkuloja këtë.

Kryeministër i ardhshëm, kandidat mandatar, zoti Konjufca të mungoi një fjalë të paktën për luftimin e korrupsionit. Nuk e pate fare në fjalor. Ndoshta nuk ka nevojë më se është luftuar krejt korrupsioni. Ose, nuk ka nevojë të luftohet se tash në pushtet jeni ju, apo nuk e di, por një fjalë nuk e pate. Asnjë!

Më beso, të dëgjova me vëmendje, nuk na e dhe fjalimin se do ta analizoja më shumë, por të dëgjova me vëmendje, nuk e përmende njëherë fjalën korrupsion, lufta kundër korrupsionit. A ta ka ndaluar ndonjëri, apo vetë e ke harruar? Ndoshta e ke harruar.

Kolegë,

Po dua të kthehem te ajo që është me rëndësi. Unë e di se ka një marrëveshje, një komplot, një situatë që duhet të shkohet më 28 dhjetor të votohet, e do të rritemi. Më 28 dhjetor vjen diaspora, e ne ia kallëzojmë vendin kësaj opozite, e kështu me radhë.

Nuk mendoj që kjo logjikë është shumë reale. Unë mendoj që është më mirë t'i kalkulojmë këto zhvillime. Për shembull, unë, besoni, do të ndihesha mirë nëse do të thoshte kryetari i Vetëvendosjes në këtë Parlament, është humbur shumë kohë, ju kërkoj falje! Për një pjesë e mbajmë përgjegjësinë, për një pjesë jo.

Do të ndihesha mirë sikur të thoshit, ju kërkojmë falje që s'i kemi bërë autorrugët. Ju kërkojmë falje që s'e kemi bërë këtë. Diçka që s'e keni bërë. Ideja që të flitet vetëm për sukseset e për të arritura, tash kur të vijë ai kurbetçiu, kur e paguan ai faturën e energjisë, të mos harroni, ata në Perëndim janë mësuar që t'i njehin me cent, ju siguroj, ai s'i ta gjejë 20 euro më shtrenjtë, do t'i ndryshojë mendja. Nuk është krejt qysh kujtojmë ne.

Tjetra, e di që karta kryesore ka qenë veriu. U bë një betejë për Komunën e Mitrovicës. Kryetari i komunës kushdo qoftë në Mitrovicë është i sfiduar. Është një komunë me shumë probleme. Komuna e Mitrovicës ka nevojë për shumë investime. Të më besoni, shumë investime. Duhet të investohet në Komunën e Mitrovicës, e në ato zona. Mirëpo, po dua t'ju siguroj edhe një gjë: ideja se çlirimi i veriut ka ndodhur me ju, ju lus shqyrtojeni pak...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, ia shtoni fjalën, ju lutem!

RAMUSH HARADINAJ: Hera e parë që po të them kryetar!

Ju lutem, veriu është jo brengë, por çështje jona. Ju i dini qëndrimet e mia lidhur me tërësinë territoriale të Kosovës edhe me integrimin dhe sundimin e rendit dhe ligjit në atë zonë. Nuk ka ndryshuar asnjëherë. Nuk ndryshojnë pse jeni ju në pushtet. Nuk mërzhitem prej suksesit të Kosovës në veri.

Ajo që më ka shqetësuar çdo herë, po jua bëj një llogaridhënie se tash ju po shkoni në opozitë, qeveria e re po vjen, ju siguroj që do ta forcojmë rendin dhe ligjin në veri edhe më shumë. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Grupi Parlamentar Multietnik, fjalën e ka Elbert Krasniqi.

ELBERT KRASNIQI: I nderuar kryetar,
E nderuar nënkryetare,

Të nderuar deputetë,

Grupi Multietnik, i përbërë prej 8 deputetëve, duhet ta prishim këtë renditjen e jombështetjes, ne e mbështetim mandatarin Konjufca edhe jemi të bindur, njëjtë sikur në Qeverinë Kurti 2, që edhe me propozimin e Kabinetit qeveritar dhe gjithëpërfshirjen e komuniteteve në këtë Qeveri do të ketë shumë projekte dhe shumë investime edhe për komunitetet në Kosovë. Kështu që, ne e mbështetim mandatarin Konjufca. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë, nuk ka të paraqitur të tjerë për diskutim. Kanë përfunduar diskutimet. Veç një sqarim procedural lidhur me zgjedhjen e anëtarëve të Qeverisë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë.

Nëse caktohen kandidatë për pozitën e ministrit apo ministres, por që nuk janë deputetë, atëherë, në bazë të nenit 96, paragrafit 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për këta ministra kërkohet miratimi formal i shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët u përkasin partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin në fjalë.

Në rastin tonë, kolegë, e kemi kandidatin për ministër Sejmur Vejshall, i cili nuk është deputet, dhe prandaj para se të procedojmë me votimin e Kabinetit qeveritar duhet të marrim miratimin për ministrin e propozuar nga radhët e komunitetit joshumicë joserb, të cilit i kërkohet miratimi formal i shumicës së deputetëve komunitet joshumicë jo serb. Pra, me fjalë të tjera, kërkohen së paku 6 vota për, të deputetëve nga komuniteti joshumicë joserb.

Të nderuar kolegë,

Meqenëse është numër i vogël dhe do të votojë vetëm komuniteti jo shumicë, joserb, atëherë do ta bëjmë këtë me ngritje dore.

Prandaj, lus të gjithë deputetët që i takojnë komunitetit joshumicë, joserb, të bëhen gati për votim me ngritje dore të deklarohen.

Kush është për?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Konstatohet se me 7 vota për, dhe 1 abstenim e kemi miratimin formal të shumicës së deputetëve nga radhët e komunitetit joshumicë joserb për kandidatin e propozuar për ministër.

Të nderuar deputetët,

Tani dua t'ju njoftoj se në bazë të nenit 95, paragrafi 3 të Kushtetutës, Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Me fjalë të tjera, nevojiten së paku 61 vota për.

Megjithatë, një sqarim teknik. Kemi deputetë që i kanë harruar kartelat, prandaj na duhen dy forma të votimit. Ata që i kanë harruar kartelat do të votojnë me dorë, ndërsa ata që i kanë kartelat në formë elektronike, dhe në fund do ta shohim rezultatin përfundimtar.

Ka miratim të deputetëve që mund ta bëjmë në një formë të vetme, meqenëse ka deputetë që i kanë harruar kartelat. Atëherë, do të shkojmë me ngritje dore.

Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen.

Kush është për?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Të nderuar kolegë deputetë,

Konstatoj se me 56 vota për, 53 vota kundër dhe 4 abstenime, Kuvendi nuk e zgjodhi Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Këtu i mbyll punimet e kësaj seance të jashtëzakonshme. Faleminderit dhe mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*